



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	D-P
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	1 faqe
Nr Prot. BrProt. Prot No.	03-3749/10
Data Datum Date	24-11-2010



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U  
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16942/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Musa Vitija nga fsh. Konjuh K. Lipjan, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151, e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 18.08.2010 merrë këtë:

**A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI:** Musa Ismajl Vitija, i lindur më 13.04.1962 në Konjuh K. Lipjan, me profesion auditor në QKU, fakultetin Ekonomik të kryer, i gjendjes së mesme ekonomike.

**Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

Sepse nuk e ka deklaruar pasurin për vitin 2009 deri me dt të 31.03.2010 në Agjensionin Kundër Korrupsionit në Prishtinë, Me veprim të tillë ka kryer veprë kundërvajtëse nga **16 paragrafi 1.1 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151**, andaj për këtë:

**G J O B I T E T**

Me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind ) Euro, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që aktvendimi të merrë formën e prerë, në dobi të AFQ i drejtësisë në Prishtinë, në gjirrollogarin rrjedhëse 1000430070000518, nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zavendsohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke ia llogaritur nga 15 Euro në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur, kurse në emër të paushallit gjyqësor është i obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

**A r s y e t i m**

Agjensioni Kundër Korrupsionit, parashtroi kërkesën nr.01/2277/10 të dt.08.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur.

Gjatë procedurës i pandehuri Musa Vitija në deklaratë tij pohoj se: Deklaroj se dikuan prej mujit 2 apo 3 te vitit 2008 kam punuar në Ministrin e Shëndetësisë në Qendrën Klinike Universitare te Kosovës, në pozitën Auditimit të brendshëm, ku ketë pozitë e kam Mbajtur gjer me dt. 25.03.2010.

Dhe prej dt. 25.03.2010 nuk jam ma në pozitën e Drejtorit të auditimit të brendshëm, por tani punoj po në të njëjtin Ministri te Shëndetësisë si auditor i brendëshum. Dhe si provë material Gjykatës ja la vendimin e Komesionit disiplinor te dt. 25.03.2010 për ulje te pozitës nga drejtori i auditimit, në adutim te brendështë. dhe si provë ja la kontratën për pozitën re Auditorit të brendshëm te cilën jam duke kryer edhe tani. Kam të shtoj se procedura e pozitës sime është kontestuse ku e ka paraqitur ankesën në Këshillin e pavarur te mbikëqyrjes te Kosovës, dhe Këshilli i pavarur mbikëqyrës i Kosovës e ka marrë vendim për përsëritjen e procedurës për rikthimin e komisionin disiplinor në QUK-së duke kërkuar rikthimin e komisionin, i cili ka qenë ma herët, dhe i vendosur në mënyrë legjitime.

Me kërkesën e ushtruar si dhe marrjen në pyetje të pandehurin, Gjyqtarja në tërësi vërtetoi që i pandehuri ka bërë kundërvajtje me të cilën e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë e shpalli fajtor dhe e dënoi si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoj këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngjashme. ,andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksa.

**VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

**GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE**

Hateme Ajvazi

